



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:186980
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640973

C.nr.1762/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit Q.E., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Bajram Mujaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „Scardian”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson M.B., nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit: 3.000€, në shqyrtimin e mbajtur me dt.17.04.2024, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me dt.22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Q.E., nga Prishtina, ashtu që :

I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „Scardian”, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt.18.08.2020, në bazë të auto përgjegjësisë, paditësit Q.E., nga Prishtina, t’ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë, dhe atë:

në emër të dëmit jo material:

- për zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 700€,
- për zhdëmtim në emër të frikës700€,

në emër të dëmit material:

- për kujdes dhe ndihmë të huaj, shumën prej 35€
- për ushqim të përforcuar 50€

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Q.E., nga Prishtina përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material dhe material, dhe atë shumat e specifikuara si në vijim: për zhdëmtimin në emër të shpenzimeve të dhimbjeve fizike shumën prej 300€, për zhdëmtimin në emër të frikës shumën prej 300€, për kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 35€, për ushqim të përforcuar shumën prej 50€, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „Scardian”, me seli në Prishtinë, që paditësit Q.E., nga Prishtina, për shumat e gjykuara si në pjesën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1.485€, me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga dt.22.04.2024, si ditë e vendim marrjes e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.119€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me padi, precizimin e saj të bërë më dt.29.03.2024, në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e nëpërmjet të autorizuarit së tij, ka parashtruar se me dt....08.2020, rreth orës 19:12, në fshatin Gj., Prishtinë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor në mes të automjetit „A”, me policë të sigurimit te Kompania e Sigurimeve „Scardian” dhe veturës „B”, me policë të sigurimit te Kompania e Sigurimeve „Sigal”, ku deri te aksidenti ka ardhur atëherë kur vetura „A” është kyç në rrugë me përparësi kalimi, pa siguri për veprimin e tij, me këtë ka goditur veturën „B”, me ç'rast paditësi ka pësuar lëndime trupore, duke përjetuar dhimbje fizike dhe frikë. Se paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të dëmit por nga e njëjta nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

Gjatë shqyrtimit, dhe pas deklarimit të autorizuarit të të paditurës se përgjegjësia është e ndarë dhe atë 50%-50%, e paditura i ka ofruar ofertë prej 500€, për mbylljen e çështjes, e të cilën ofertë nuk e ka pranuar pala paditëse. I autorizuari i paditësit pas nxjerrjes së ekspertizave ka bërë precizimin e kërkesë padisë.

Në shqyrtimin e datës 27.03.2024, e paditura i ka ofruar ofertë të re, duke u bazuar në përgjegjësin e ndarë si më lartë, dhe atë shumën prej 800€ për mbylljen e çështjes në tërësi, e bazuar në lëndimet e lehta trupore, edhe këtë ofertë pala paditëse e ka refuzuar.

Në fjalën e tij përfundimtare ka ritheksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit të saj, duke kërkuar nga gjykata që kërkesë padinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar, nga se vlerësojnë se me provat e administruara është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe lartësia e saj, dhe që gjykata me rastin e vendosjes të merr parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertit komunikacionit rrugor të dt.11.03.2023, dhe mendimin e ekspertit mjekësorë të dhënë si në procesverbalin e shqyrtimit kryesore të dt.27.03.2024, andaj nga të lartcekurat ka kërkuar nga gjykata që kërkesë padinë e paditësit të precizuzr t'a aprovoj në tërësi, si të bazuar. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 104€, për taksë për padi shumën prej 21€, për shpërblimin për ekspertin e komunikacionit shumën prej 150€, për shpërblimin për dy ekspert mjekësore shumën prej 200€, për katër seancat e mbajtur shumën prej 135€, si dhe për precizimin e padisë shumën prej 104€.

E paditura në përgjigje në padi të ushtruar me dt.05.08.2022, e ka kundërshtuar padinë si për nga baza ashtu edhe nga lartësia në mungesë të provave, duke theksuar se pala paditëse nuk është paraqitur me kërkesë për kompenzimin e dëmit në procedurën jashtë gjyqësore, ka kërkuar që pala paditëse t'i drejtohet në procedurën jashtë gjyqësore të paditurës, për shkak të ekonomizimit të procedurës.

Në seancën përgatitore, nuk ka marrë pjesë por me telefon ka udhëzuar që të mbahet seanca në mungesë të saj,

Ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar propozimin për kryerjen e ekspertizës mjekësore, si të pa nevojshëm, pasi që paditësi ka përjetuar lëndime të lehta trupore, dhe se konsiderojnë se përgjegjësia është e ndarë me 50%-50%, dhe për këtë kanë ofruar ofertë prej 500€, për mbylljen e çështjes e cila është kundërshtuar nga pala paditëse. Edhe në shqyrtimin e dt.27.03.2024, i ka ofruar ofertë të re në shumë prej 800€ e cila ofertë gjithashru është refuzuar nga pala paditëse.

I aut. i të paditurës në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se edhe më tej mbesin në tërësi pranë pretendimeve të theksuara, se bazës juridike të kërkesë padisë nuk është kontestuese e as përgjegjësia e ndarë prej 50%-50% , e vërtetuar me ekspertizën e komunikacionit.

Lartësinë e kërkesë padisë e ka kundërshtuar si tejet të lart, dhe jo proporcionale me lëndimet të lehta trupore që i ka pësuar paditësi. E paditura ka mbetur pranë ofertës së dhënë në shumë prej 800€, për të gjitha format e dëmit material dhe jo materialë për 50% të përgjegjësisë që i takon.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit mbi shumën e ofruar nga e paditura, t'a refuzoj si të pa bazuar. Lidhur me kamatën e kërkuar ka deklaruar se e kundërshtojnë si të pa arsyeshme, për faktin se paditësi nuk e ka pranuar përgjegjësinë në shkaktimin e këtij aksidenti, e që edhe në seancën e parë e paditura e ka njoftuar se kanë të bëjnë me ndarje të

përgjegjesisë, por nuk është bindur derisa është nxjerr ekspertiza e komunikacionit. Shpenzimet e procedurës i ka kundërshtuar të gjitha ato që janë krijuar për fajin e paditësit.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, këtë çështje juridike, zhvilloi procedurën e provave në të cilën u lexua dhe u shiqua si provë: raporti policorë Dr-3004-...0 i dt....08.2020, raporti mjekësorë nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, i dt...08.2020, Kërkesa drejtuar KS „Scardian” e dt.20.10.2020; ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing.Vedat Bajraktari, e dt.11.12.2023, deklaratat e autorizuarve të palëve ndërgjyqësore, si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.

Pasi gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç e në lidhmëni njëra me tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me administrimin e provave gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se në rrugën nacionale Prishtinë-Pejë, në fshatin Gj. me dt...08.2019, rreth orës 19:12, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor, në mes të automjetit (A) të markës „Opel Zafira”, me tabela të regjistrimit 07..., të cilin e ka drejtuar G.G., nga M., dhe automjetit (B) të markës „Renault Megane”, me tabela të regjistrimit 01...-JC, të cilin e ka drejtuar Q.E., nga Prishtina (*këtu pala paditëse*), ku deri te aksidenti ka ardhur: kur drejtuesi i automjetit (A) ishte duke lëvizur nëpër rrugën lokale të fshatit Gj., dhe kur ka arritur në kryqëzimin me rrugën nacionale Pejë-Prishtinë, bënë kyçje të pa sigurt, duke mos qenë i bindur dhe i sigurt më parë, se me një veprim të tillë nuk rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ndërsa automjeti (B) po lëvizte nëpër rrugën nacionale Pejë-Prishtinë, dhe në momentin kritik kur automjeti (A) po kryente kuqje, duke mos mbajtur distancën e duhur të sigurisë me automjetin të cilin e kishte para tij, shmanget dhe kalon në shiritin e kundërt të qarkullimit, të cilin veprim e kishte të ndaluar me shenjë korizontale-*vijë e plotë*, dhe ndeshet me automjetin (A) dhe atë me pjesën e tij të përparme të anës së djathtë, ku shkaktohen lëndime të lehta trupore për paditësin, ku si pasojë e aksidentit, i njëjti dërgohet në mjekim në Emergjencë, në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, për t’u ofruar ndihmë mjekësore, për shkak të lëndimeve përjetuara(dhimbjes dhe frikës).

Pas administrimit të provave dhe pohimit të autorizuarave të palëve ndërgjyqësore, gjykata ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit në mes të automjeteve („A” dhe „B”), ka të bëjë me përgjegjësi të ndarë 50% me 50%.

Baza juridike e kërkesëpadisë me pajtimin e palëve ndërgjyqëse është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Ing.Vedat Bajraktari, të dt.11.12.2023, ku për palët ndërgjyqëse më nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë,

Mendimi i gjykatës që e paditura të jetë përgjegjëse për ta kompensuar paditësin, gjen mbështetje në dispozitat e nenit 136,137,159 par.1, dhe 140 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD). *Me dispozitën e nenit 136 të këtij ligji parashihet se kush tjetrit i shkaktonte dëm ka për detyrë ta kompensoi atë-përveç nëse provon të kundërtën...,me dispozitën e nenit 137 sqarohet se dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt dhe parandalim i shtimit të kësaj pasurie si rezultat i dhimbjeve ose frikës së përjetuar, ndërsa neni 159 par.1 parasheh se në qoftë se dëmi është shkaktuar nga automjeti në lëvizje dhe për fajin e vetëm të një zotëruesi vihen në zbatim rregullat e përgjegjesisë mbi bazën e fajit, ndërsa neni 140 thotë se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.*

Gjykata për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, me pajtimin e palëve ndërgjyqëse në cilësinë e provës në seancën e dt.27.03.2024, ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga ekspertët Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër, dhe Dr.Florim Bajraktari, ortoped-traumatolog, e të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional drejtpërdrejtë në procesverbalin e cituar, me ç’rast janë

deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi në aksidentin e përmendur e duke sqaruar se paditësi ka pësuar këto lëndime trupore, gjatë aksidentit të dt.18.08.2020, dhe atë: ndrydhje të kokës, qafës dhe të krahorit, të cilat llogariten si lëndime të lehta trupore, me ç'rast ka përjetuar dhimbje fizike:

-të intezitetit të lart në kohë zgjatje prej një ore (*kohë e nevojshme deri në dërgimin e tij në Spital- Emergjencë, si dhe për rehabilitim mjekësorë*),

-të mesme në periudhë kohore prej tri javësh (*periudhë kjo e nevojshme deri në tërheqjen e inflamacionit posttraumatik*),

-të ulëta në kohë zgjatje prej gjashtë javë, e të theksuara gjatë sforcimeve fizike gjatë ndryshimeve klimatike. Eksperti ka dhënë mendim edhe për:

- ndihmë dhe përkujdes të huaj, i cili ka qenë i nevojshëm në periudhë kohore prej shtatë ditësh,

-për ushqim të përforcuar i cili ka qenë i nevojshëm në periudhën kohore prej 10 ditësh (*i pasur me vitamina, minerale etj.*),

-për terapi fizikale ka pas nevojë për së paku dy herë nga 7 ditë, çdo 6 muaj, vitin e parë. *Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm mjekësorë dhe shëmtim trupor ka deklaruar se nuk ka.*

Eksperti i psikiatrisë, pas ekzaminimit direkt ka konstatuar se: paditësi ka përjetuar frikë dhe atë primare:

-të intezitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave (*kjo periudhë është përcjellë me shtangim afektiv dhe frikë nga vdekja e drejtë për drejtë*),

-sekondare të intezitetit të lartë ka pasur në kohëzgjatje gjerë në tri orë, duke e llogaritur kohën nga momenti i aksidentit, dërgim i tij në Qendrën Emergjente të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, ku janë bërë egzaminimet dhe rehabilitimi mjekësore (*kjo periudhë është e përcjellë me të rrahura të shpejtuara të zemrës frymarrje të vështirësuar, dridhje të muskujve dhe ankesa të tjera trupore.*),

-sekondare me intensitet të mesëm, ka pasur në periudhën kohore gjer në katër javë, të manifestuar me një çrregullim afektiv afatgjatë, si pasojë e aksidentit (*si pengesa të herë pas hershme në gjumë rikujtim të ngjarjes traumatike, indisponim dhe pengesa të tjera trupore.*), dhe

-sekondare me intezitet të ultë ka pasur në periudhën kohore gjerë në tre muaj (*e që manifestohet gjatë kohës kur ka dal në komunikacion apo ngjarjet që ja rikujtojnë aksidentin*).

Gjykata në tërësi i ka pranuar mendimet profesionale të ekspertëve në fjalë, të njëjtave ju fali besimin në tërësi, pasi që të njëjtat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, dhe janë në harmoni me provat që gjithashtu janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës ,e të cilave i'a shtojmë dhe faktin se pala e paditur nuk ju ka bërë vërejtje, për çka gjykata konsideron se ky mendim i ekspertëve është i pa kontestueshëm.

Gjykata për lartësinë e kërkesëpadisë, për kategoritë e cekura të dëmit jo material vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 183 të LMD-së, e lidhur me nenit 323 të LPK-së, pra duke marrë për bazë gjithmonë rendësin e shkeljes së të mirës, qëllimit që i shërben kompensimi i gjykuar, duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarit, e nën supozimin se kompensimi i gjykuar do të ndikoj në zbutjen e pasojave negative që i janë paraqitur paditësve si rezultat i dëmtimeve të pësuar në aksident, pra gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke marrë për bazë natyrën dhe shkallën e lëndimeve, pasojave dhe frikës intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, vendosi si në pjesën aprovuese të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i caktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit-pjesa aprovuese, për paditësin nuk është shpërblim i plotë, mirëpo është satisfaksion dhe i drejtë për të, andaj edhe është vendosur si në pjesën aprovuese, ndërsa përtej shumës së aprovuar për kategoritë e dëmit jo material dhe material si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit, gjykata refuzoi shumat dhe atë: për zhdëmtimin në emër të shpenzimeve të dhimbjeve fizike

shumën prej 300€, për zhdëmtimin në emër të frikës shumën prej 300€, për kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 35€, për ushqim të përforcuar shumën prej 50€, *duke marrë parasysht përgjegjësinë e ndarë*, për faktin se shpërblimi i dëmit jo material dhe material nuk mund dhe nuk duhet t'i shkojë përshtati synimeve të padrejta, dhe vlerësoi si të pa drejtë shumën e kërkuar përtej shumës së aprovuar, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në pjesën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, përtej shumës së gjykuar, duke marrë parasysht se të autorizuarit e palëve ndërgjyqësore e kanë pohuar faktin se kontribues në aksidentin e komunikacionit rrugorë të dt.18.08.2020, janë të dy palët(*pjesëmarrësit në aksidentin lëndorë*), që do të thotë se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë 50% me 50%, e pas konstatimit të ekspertëve mjekësor: Florim Bajraktari, ortoped-traumatolog dhe Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër, lidhur me dëmin material dhe jo material të paditësit të pësuar në aksidentin e lartcekur, gjykata e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 685€.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysht të gjitha pretendimet e palës paditëse në kuptim të pretendimeve nga padia dhe ato gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për arsye se në rastin konkret me provat prezent në lëndë është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, në kuptim të dispozitave të cekura më lartë.

Në rastin konkret me provat e administruara nga gjykata sipas propozimeve të palëve, pala paditëse nuk mundi të argumentoi kërkesën e saj për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë.

Vendimi për kamatë gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ngase konsideron se nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit, pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, me arsyetim se nga ky moment e paditura kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit që i'a ka shkaktuar palës paditëse, andaj edhe është vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së, ashtu që e paditura është e obliguar që paditësit të i'a paguaj shumën prej 1.119€, dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 104€, për prezicimin e kërkesëpadisë shumën prej 104€, për përfaqësim në katër(4) seanca të mbajtura nga 540€, për taksën gjyqësore shumën prej 21€, shpërblimin për dy ekspert mjekësor shumën prej 200€, dhe për ekspertin e komunikacionit shumën prej 150€.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.1762/20, me dt.22.04.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.